



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 30.10.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Prezantimi dhe shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9942 datë 26.06.2008 “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit ne organizimin e njeriut”, të ndryshuar”” (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Robert Bitri, Andrea Marto, Tatiana Nurçe, Gjetan Gjetani, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Dritan Bici, Arlind Çaçani, Halit Valteri, Nimet Musaj, Kujtim Gjuzi, Klajdi Qama, Zef Shtjefni, Ardit Konomi dhe Ilir Pendavinji.

Mungojnë:

Lefter Koka, Eglantina Gjermani dhe Rrahman Rraja.

Të ftuar:

Roland Kristo – Zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Antoneta Njehrrëna - Drejtore e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale

Jolanda Hyska – Përfaqësuese e Institutit të Shëndetit Publik

Areti Baruka – Përfaqësuese e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor

Ardian Paravani – Përfaqësues i Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor

Ledio Ilollari – Përfaqësues i AKU-së

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e datës 30.10.2019 të Komisionit të Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit. Kjo është seanca e tretë e diskutimit të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9942 datë 26.06.2008 “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizimin e njeriut”, të ndryshuar””. Relator i këtij projektligji është zoti Besnik Baraj.

Dje kemi bërë një takim të përbashkët me Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, për të rakorduar që në proces sa më shumë të jetë e mundur qëndrimet. Kemi dy amendamente, të cilat i kemi prezantuar dhe diskutuar dje në takimin e përbashkët ndërmjet dy komisioneve, një amendament i propozuar nga zoti Baraj dhe një amendament i propozuar nga zoti Balla.

Amendamenti i parë i propozuar nga zoti Baraj, të cilin e keni të gjithë përpara në dispozicion synon të mos e bëjë të detyrueshëm, por t’ia lërë si të drejtë institucioneve të monitorimit dhe të inspektimit kontrollin në pikën doganore për çdo ngarkesë. Pra, çdo ngarkesë duhet të jetë e detyruar me ligj që t’i bëhen analizat, duke marrë mostrat dhe duke bërë analizën për të verifikuar përputhshmërinë me etikën dhe gjëja tjetër është që institucionet e inspektimit, mendoj se do të ishte mirë që t’i fiksonim më mirë në ligj, sepse mesa duket ka një lloj kakofonie, të ushtrojnë të drejtën e tyre për të inspektuar dhe për të verifikuar sa herë ata e çmojnë me risk, sipas analizave të tyre të riskut, ngarkesat në doganë.

Dje ka pasur shumë diskutime, gjithsesi nuk besoj se kanë shteruar, por kur ta diskutojmë projektligjin nën për nën, do të mbajmë në konsideratë edhe amendamentet dhe më pas me kontributin dhe votën tuaj do të vendosim për një prej dy opsioneve.

Amendamenti tjetër i zotit Balla, ka disa ndryshime në ligj. Njëri prej këtyre ndryshimeve është një riformulimin i nenit 9, që ka lidhje me përjashtimet nga detyrimi për fortifikimin me jod të kripës, pra bëhet fjalë vetëm për rastin e kripës që importohet si lëndë e parë me qëllim fortifikimin. Rasti dytë është për kripën që importohet e pajodizuar, por me destinacion rieksporin, kryesisht nga kompanitë e përpunimit të peshkut apo të ushqimeve që janë një lloj fasonerie apo që punojnë për eksport. Këto kompani nuk janë të detyruara, sipas këtij amendamenti, që në fakt përputhet edhe me opinionin e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale

dhe Shëndetësinë, të përdorin kripë të jodizuar, sepse tregjet ku eksportohen jodetyrimisht e kanë këtë kërkesë, pasi jo të gjitha vendet kanë deficiencë jodi. Ne jemi të sforcuar që të parashikojmë me ligj disa detyrime të forta për fortifikimin me jod të kripës, për shkak se sipas të dhënave kemi deficiencë të lartë jodi në popullsi, gjë që bëhet më pas premisë për sëmundje të ndryshme.

Në amendamentin e zotit Balla ka edhe një propozim tjetër, që në rastet përjashtimore t'u lihet si e drejtë ministrit të Bujqësisë dhe ministrit të Shëndetësisë, që me një udhëzim të përbashkët të listojnë ato lloje ushqimesh që lejohen të tregtohen pa kripë të jodizuar në vend. Nga ato që u diskutuan dje, gjithsesi këtë do ta vendosim edhe me votë, anëtarët e të dy komisioneve ishin të një mendimi që nuk duhet të lihet kaq e hapur, por nëse ka ndonjë tipologji ushqimesh ose procesesh, të cilat jodetyrimisht duhet të përdorin kripën e jodizuar duhet të specifikohet në ligj, siç është për shembull rasti i proceseve kalimtare, ku dje i si shembull u morr regjja e açuges, jo përfundimtare. Pra, kripa përdoret për këto procese, më pas shpëlahet dhe në fund fare për produktin final përdoret kripa e jodizuar, nëse duhet kripa. Kjo duhet të specifikohet në ligj për t'i mos i lënë shumë hapësirë vendimmarrjes subjektive apo politike, konkretisht përfaqësuesve të ministrave, sipas propozimit.

Këto janë diskutimet e deritanishme.

Sot në komision ndodhen përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë, zoti Roland Kristo, zëvendësministër, i cili ka qenë i pranishëm në të gjitha takimet tona. Nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale janë të pranishme zonja Antoneta Njehrrrena, Drejtore e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, zonja Jolanda Hyska, përfaqësuese e Shëndetit Publik, zonja Areti Baruka dhe zoti Arian Paravani, përfaqësues të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor.

I pranishëm është edhe zoti Ledio Ilollari, përfaqësues i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Pra, të pranishëm janë përfaqësues nga të gjitha institucionet relevante për çështjen dhe seanca e sotme do të jetë shteruese. Gjithsesi, nëse nuk bëhemi dot gati, votimin mund ta lëmë për një seancë tjetër.

Fjalën e ka relatori zoti Baraj, nëse ka ndonjë gjë për të na prezantuar.

Besnik Baraj – Unë mendoj se të gjitha problemet ju i ezauruan. Bëtë një panoramë të plotë të asaj që kemi diskutuar deri tani.

Unë dua të sqaroj arsyen pse është bërë propozimi për heqjen e kontrollit të detyrueshëm nga subjektet private që kryejnë analizat kimike, gjithashtu, dua të mos ndodhë edhe ndonjë

keqkuptim me ndonjë koleg, siç ndodhi dje. Ne nuk jemi për moskontrollin e përmbajtjes së jodit. Madje unë mendoj se duhen kontrole edhe për substanca të tjera toksike që janë normalisht shoqëruese të këtyre produkteve ushqimore, pra të bëhen në mënyrë analoge, siç bëhen për jodin, por kjo gjë duhet bërë nga institucionet shtetërore, sepse për mua janë më të besueshme dhe aq më tepër kur ekziston ky problem që ju keni ekspozuar në relacion, në publik, në ligj, unë e quaj diskriminim që këtë ta marrë përsipër subjekti privat. Kjo bie në kontradiktë me shumë marrëveshje ndërkombëtare.

Unë bëra edhe një pyetje, por që nuk m'u dha përgjigjja: Maqedonia, e cila, kur nuk e jodizon kripën, ka probleme të ngjashme me ne, por fakti që e kontrollon dhe e jodizon e ka ulur problematikën në nivele jo shqetësuese. A e ka detyruar ajo subjektin në mënyrë të tillë? Ne mund ta verifikojmë këtë gjë, sepse kemi kolegë nga Maqedonia e Veriut, si edhe është shteti që e ka marrë në dorë këtë problem. Pra, institucionet përkatëse të mbajnë përgjegjësinë e matjes së jodit konform ligjit.

Gjithashtu, e dimë që një sërë produktesh kontaminohen nga mikrotoksinat që zhvillohen në procesin, e ruajtjes, magazinimit e të tjera. Problematika e tyre shfaqet pasi është konsumuar ushqimi, pas 10 ose 20 vjetësh, dhe ajo që është më e rënda është se një pjesë të tyre nuk kanalizoheshin dot deri para disa vitesh në Shqipëri. Prandaj, të mos detyrosh subjektet për këto që janë substanca toksike dhe të detyrosh subjektet për gjëra të tjera mua më duket diskriminim. Pra, unë do të thosha që këtë përgjegjësi duhet ta matë shteti. Ka mjaftueshëm laboratorë, madje unë nuk jam për laboratorët private, vlerësoj ato shtetërore. Unë jam i asaj fushe se me analiza laboratorike jam marrë gjithë jetën. Aty ku ka seriozitet, ku investohet në pajisje, në njerëz dhe burimet njerëzore, shteti e bën më mirë se çdo privat.

Niko Peleshi – Tani fillojmë me përgjigjet dhe diskutimet në parim.

Dritan Bici - Unë jam dakord me propozimet e Komisionit të Shëndetësisë. Megjithatë, duke marrë shkas nga realiteti ushqimor në Shqipëri, që për mua më duket se njerëzit janë kthyer në kavië laborator, vdekjet nga kanceri janë shtuar shumë, unë shikoj një anarshi sa i përket kontrollit të produkteve ushqimore në përgjithësi dhe disa produkteve të përcaktuara në veçanti.

Unë nuk jam nga ata që ju kam keqkuptuar, por ju kam mirëkuptuar për problemet që i shkaktohen biznesit dhe nuk folën për problemet që i shkaktojnë shëndetit të njerëzve. Nuk ju kam keqkuptuar, por ju kam mirëkuptuar se ju keni hallin e bizneseve. Në vend që të diskutoni hallin e njerëzve, ju diskutoni se ky veprim që do të ndërmarrim ne, sipas Komisionit të

Shëndetësisë, i krijon probleme biznesit. Unë nuk jam dakord. Ne jemi deputetë dhe populli na ka votuar për të mbrojtur interesat publike dhe pastaj ato të bizneseve. Nuk jam për t'i nëpërkëmbur ata dhe për t'u krijuar probleme bizneseve, por unë jam për atë që ne duhet të jemi shumë të ashpër sa i përket kontrollit ushqimor dhe vlerësimit të jodit të kripa, sepse bëjmë ende pjesë në vendet e botës së tretë, që i kishte ndarë ata, nuk e di kush i kishte ndarë, dhe ne si popull jemi ende si vendet e botës së tretë sa i përket shëndetit në këtë aspekt. Kështu që unë jam i asaj linje, i qëndroj asaj linje, nuk kam kurrfarë asnjëlloj keqkuptimi, për mua në radhë të parë është shëndeti i njerëzve, pastaj vijnë problemet e tjera. Pra, para shëndetit të njerëzve unë nuk e llogaris fare se çfarë mund të humbasin bizneset, kanë ose jo burokracira apo gjithçka tjetër.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Fjalën e ka zoti Baraj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, zoti Baraj, dua të bëj një ndërhyrje të vogël! Unë nuk dua të bëj përkthyesin, sepse zoti Baraj do të flasë vetë, por i bashkohem mendimit kur bëhet fjalë për të reduktuar burokracitë. Këtu nuk është çështja si t'ua bëjmë punën më të lehtë bizneseve, por edhe kjo është komplet legjitime. Çështja është se sa herë që ka burokraci ka mundësi për ryshfete dhe për korrupsion, pra besoj se është e kundërta e asaj që ngrini ju. Në qoftë se ne do të vendosim burokraci që çdo ngarkesë duhet t'u nënshtrohet analizave, pavarësisht se inspektoratet përkatëse e kanë këtë të drejtë, në qoftë se e vlerësojnë me risk, nuk i pengon kush që të bëjnë analiza për çdo ngarkesë. Në qoftë se ne e bëjmë me ligj si detyrim, atëherë këtu lind mundësia për ryshfete, sepse biznesi do që t'i kalojë shpejt, ndërkohë që inspektori mund t'i thotë: "Hajde pasdite, se tani kam disa punë", por pasdite biznesit i humbet tregu e të tjera. Pra, biznesmeni do të detyrohet t'i japë lekë nën dorë inspektorit që të shpejtojë procedurën. Besoj se këtu është çështja dhe jo për të mbajtur anën e shëndetit publik apo të biznesit, që të mos spekulojmë se kjo nuk është e lehtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ato na përkasin ne, sepse ne duhet të bëjmë ligje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fillon që nga ligji, zoti Dritan! Pra, në qoftë se ne bëjmë ligje të ndërlikuara, me procedura burokratike, atëherë do të krijojmë hapësira për korrupsion dhe për ryshfet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dritan Bici– Ne nuk krijojmë hapësira për ryshfet, por u japim mundësi organeve të kontrollit shëndetësor që të bëjnë kontrollin, sepse ne jemi dëshmitarë se çfarë ndodh me produktet e rëndomta. Ne jemi dëshmitarë se çfarë bëhet në Maminas, ku ka vende enkas ku ndërrohen etiketat e produkteve, ndërkohë që kjo nuk ka asgjë të keqe, sepse i kushtohet rëndësi një produkti që përdoret në masë. Ky produkt ka efektin e tij ndaj problemeve në qoftë se nuk është në përqindjen e caktuar, sepse, në qoftë se e ka përqindjen, nuk ka përse dikush të paguajë lekë nën dorë apo ryshfet që të marrë analizën e caktuar.

Niko Peleshi - Unë e kisha fjalën për vonesat, megjithatë nuk është një çështje kaq e rëndësishme.

Fjalën e ka Zoti Baraj.

Besnik Baraj – Në asnjë rast unë nuk jam shprehur se duhet të favorizojmë një biznes apo tjetrin. Shumë mirë dikush mund të thotë se ky detyrim që u vihet atyre mund të bëhet, se lobohet për të favorizuar një biznes tjetër brenda vendit. Pra, mund të aludohet, por në këtë rast të gjithë duhet të jenë të barabartë para ligjit dhe para detyrimeve ligjore, që kanë të bëjnë me përbërësit ushqimorë dhe substanca të ndryshme që e përbëjnë atë.

Zoti Dritan, unë nuk besoj se këtu ka ndonjë që të thotë se biznesi është përpara shëndetit të popullit dhe më duket shumë propagandistike kur thuhet kjo fjalë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni një minutë! Ne do të flasim këtu si individë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po them edhe diçka tjetër: në qoftë se ka persona, të cilët nuk kanë qenë asnjëherë të lidhur me biznesin, unë jam një prej tyre që nuk kam pasur asnjëherë lidhje në jetën time me asnjë aktivitet. Sot e kësaj dite unë nuk kam lidhje me asnjë lloj biznesi, kështu që jam shumë indiferent në këtë drejtim.

Niko Peleshi – Të mos e marrim si personale, sepse ishte në parim.

Besnik Baraj – Edhe kur flasim që është shtuar sëmundja e kancerit, ata persona aty kanë statistika dhe mbi bazën e statistikave ne mund të bëjmë vlerësime reale. Pra, me opinione lart e poshtë, nëse është shtuar kjo apo është shtuar ajo tjera, ne, si deputetë, nuk kemi të drejtë të shpërndajmë të tilla opinione, sepse këto janë muhabete kafënesh, të cilat ne shpeshherë i bëjmë prezente në tavolina dhe në parlament. Unë e ritheksoj edhe njëherë: ka shumë produkte ushqimore, që mund të përbëjnë risk për shëndetin e shqiptarëve. Pa dyshim jo vetëm ato, por të

gjitha produktet duhet të analizohen në mënyrë periodike, kurse për produktet që përbëjnë risk duhet të analizohet çdo lloj porcioni që futet në Shqipëri. Nga ajo që tha zëvendësministri, përgjithësisht unë kuptova që ky klasifikim bëhet, por të monitorohen dhe të analizohen të gjitha produktet që paraqesin risk, pavarësisht nëse vjen apo jo fleta e kontrollit.

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Atëherë, vazhdojmë me pyetjet për përfaqësuesit e institucioneve, patjetër edhe me komente.

Zoti Gjuzi, e ka fjalën.

Kujtim Gjuzi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, kolegë!

U uroj mirëseardhjen edhe të ftuarve nga administrata shtetërore.

Unë mendoj se ka një lloj konflikti psikologjik brenda komisionit, kur dy anëtarë të komisionit debatojnë dhe mbajnë gati 20 minuta komisionin në debat. Kjo është gjë e mirë, nuk është gjë e keqe, por le t'i shikojmë më mirë dy projektet që kemi këtu, njëri që vjen nga deputeti Taulant Balla dhe tjetri vjen nga profesor Baraj. Unë normalisht jam gjithmonë me akademikët, nuk jam me politikanët. Po sikur të shikohet më gjerë që të mos kemi korrupsion në doganë, sepse që kemi korrupsion në doganë ne të dy, zoti kryetar, e dimë më mirë se të tjerët, apo jo? Pra, pa paguar para në doganë nuk ka medikamente që të futen në Tiranë. Ti mund të pyesësh: “Po ti, zoti Gjuzi, e ke bërë ndonjëherë këtë punë?” Çfarë thua? Më kanë lënë kamionin 3 ditë dhe 3 net me frigorifer ndezur dhe, po të mos paguaja, nuk më lëshonin, por ndonjëherë kur nuk doja të paguaja vetëm nga frika më lëshonin, sepse kishin frikë se mos Gjuzi bën zhurmë dhe thoshin: “Më mirë të ikë ky e të kemi punë me këta të tjerët”. Nëse këtu brenda, e shikoj se ka një variant si ai i Taulant Ballës, ka një hapësirë që dikush do ta kontrollojë në mënyrë private doganën, unë nuk jam dakord me këtë. Kontrollin duhet ta bëjë gjithmonë shteti, sepse shteti është kontrolluesi, unë jam biznesmeni, ai tjetri është qytetari.

Dakord, tregun e kemi mbushur dhe është plot, por mendoj se specialistët duhet të dalin, tani e kam me ju, nga faza që jemi kështu apo ashtu dhe të bëjnë më të mirën e mundshme, pra edhe ju të mos shkoni përmes inspektoratit dhe të thoni se duhet të paguani lekë, aq sa është përqindja, që ta kalojmë. Nëse e bëjmë këtë, vota ime do të ishte pro, por nëse jo, unë nuk do ta jap votën kundër, sepse duhet jodi, por do të abstenoj. Ftoj edhe kolegët e mi, të platformës me

ide të djathta, që për momentin ta abstenojnë që të vijë në parametra. E kemi sjellë parlamentin në parametra, ta sjellim edhe komisionin, ku ka gjë më të mirë.

Zoti kryetar, kërkoj që herë të tjera të mos loboni brenda komisionit, sepse ka konflikt interesash pastaj. Për këtë unë do të abstenoj dhe dua edhe leje të iki.

Niko Peleshi – Këtë thuaj se ke punë. Pra do të ikësh?

Kujtim Gjuzi – Po, do të iki, sepse e shikoj se ka konflikt mes zotërisë, që thotë jemi tek e majta, pra është politikë e majtë..., pra ka konflikt me profesorin. Tani kujt t'i jap të drejtë?

Niko Peleshi – Ka diskutim, nuk ka konflikt.

Deputet – Ky është emancipim, pra brenda një grupi ka mendime të kundërta

Kujtim Gjuzi – Nuk e vë në diskutim që ka emancipim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Dakord. Kush e do fjalën? Po diskutojmë në parim, që të mos flasim për nene të veçanta.

Po, zoti Valteri.

Halit Valteri – Unë nuk isha pjesë e diskutimit dje, por mendoj se ramë dakord për variantin e Komisionit të Shëndetësisë, ashtu siç ishte. Prandaj ftoj të gjithë kolegët e opozitës të votojnë variantin e Komisionit të Shëndetësisë.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Përfaqësuesit e ministrive a kanë ndonjë gjë për të prezantuar?

Specialiste – Më lejoni...

Niko Peleshi – Më fal, ne si komision do të diskutojmë për draftin e Këshillit të Ministrave.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kemi edhe draftin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta sqaroj, ne kemi variantin e Këshillit të Ministrave, për të cilin do të diskutojmë, ndërkohë për referencë dhe për konsultim gjatë votimit nen për nen kemi edhe draftin e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, sepse ata nuk e kanë përfunduar dhe e kanë në diskutim, prandaj e bëmë edhe mbledhjen e djeshme për orientim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, diskutimin do ta bëjmë për variantin e Këshillit të Ministrave, kur të kalojmë nën për nen, do të konsiderojmë edhe amendamentet, edhe punën e deritanishme të Komisionit të Shëndetësisë, për të bërë rekomandimet tona si komision mbështetës.

Po, Berti.

Robert Bitri – Një pyetje kam, mbase teknike, jodi nga pjesa e kripës për sa kohë largohet?

Jolanda Hyska – Në varësi të llojit të fortifikimit, ne e përdorim ose jodur kalium ose jodat kaliumi. Nëse është jodur kaliumi, jetëgjatësia e tij në kripë është 6 muaj; nëse është jodat kaliumi, atëherë koha e qëndrimit në kripë është më e gjatë dhe data e skadencës zgjat deri në një vit. Por nuk mjafton vetëm forma e fortifikimit, që të përcaktohet se sa do të qëndrojë niveli i jodit në kripë, ka rëndësi shumë edhe mënyra se si ruhet, pra nga lloji i ambalazhimit, temperatura, lagështira dhe mënyra e transportit që përfshin edhe kushtet mjedisore.

Niko Peleshi – Faleminderit!

Po, zoti Baraj.

Besnik Baraj – Kam një përgjigje të vogël lidhur me këtë. Këtu kam një artikull që është botim shumë i vjetër dhe futja e jodit ka filluar diku nga viti 1920 e ca dhe kjo problematikë është studiuar në vite. Nga ajo që thoni ju, ka rëndësi edhe se sa është sasia që humbet në përgjithësi. Sigurisht, kjo është në interval, sepse varet, siç thatë edhe ju, nga temperatura dhe lagështia, por rëndësi shumë të madhe, që sot në një farë mase është eliminuar, është edhe ambalazhimi. Pra, përpara, kur përdorej karton, jodi humbiste shumë, ndërsa tani në mënyrën se si ruhet në plastikë e të tjera, nuk humbet më shumë se 20 – 30%, edhe mbas 6 muajsh, veçanërisht jodati i kaliumit ose i natriumit. Pra, sasia që humbet është e vogël. Shpesh ato shtresëzohen, pra për shkak të regjimit mund të dalë jod i lirë dhe mund të largohet, sepse është volatil, por sasia nuk shkon në zero, pra që të thuhet nga 100% jod që kemi mbas 6 muajsh u bë zero, jo, ajo ulet rreth 20 deri në 30%. Por ka edhe raste kur ambalazhimi është i mirë, që për 6 muaj nuk ndryshon fare. Ky është një botim i bërë në Britaninë e Madhe, nuk është botim me autor shqiptar.

Niko Peleshi – A ka pyetje?

Po, zonja mund të bëjë një sqarim.

Jolanda Hyska – Profesor Baraj ka të drejtë në shpjegimin që jep, por në kuadrin e fortifikimit, kur zgjidhet fortifikimi me jod i kripës, në varësi të gjendjes kombëtare të deficencës

jodike, përcaktohen edhe nivelet. Përcaktimi i niveleve është i ndryshëm. Përcaktimi i jodit në kripë është i ndryshëm në nivel prodhimi, është i ndryshëm në nivel të pikave të tregtimit me shumicë, është i ndryshëm niveli i jodit që kërkohet në pikat me pakicë dhe është i ndryshëm niveli i jodit që kërkohet në nivel familjeje. *Range* në Shqipëri është 40-60 në nivel prodhimi dhe importimi; 20 PPM jod për kilogramë kripë në nivel të tregtimit me pakicë dhe 15 PPM jod në kripë në nivel familjeje. Monitorimi bëhet pikërisht duke iu referuar këtyre përqendrimeve. Nuk mund t'i rrisim apo t'i ulim në një kufi të caktuar nivelet e jodit, sepse edhe përcaktimi i këtyre niveleve është i tillë për Shqipërinë, kurse në vende të tjera janë të ndryshme. Pra, varet nga shkalla e deficiencës jodike dhe nga shkalla e gravitetit të deficiencës jodike.

Në popullatë ka pasur një gravitet të rëndë kur ka filluar fortifikimi për herë të parë në vitin 1996, e kemi pasur 100 PPM, sepse 97,3% të popullatës e kemi pasur me deficiencë dhe 67% me deficiencë të rëndë. E thënë me terma mjekësorë, deficiencë e rëndë do të thotë të kesh të pranishëm te fëmijët dhe tek të rriturit, por veçanërisht te fëmijët, strum dhe, mbi të gjitha, kretinizëm, që është e papranueshme. Atëherë kemi pasur nivele të larta, ndërsa sot nivelet janë ulur, sepse ndërhyrjet që u bënë sollën përmirësime.

Niko Peleshi – Më fali, kam një pyetje.

Cili është thelbi i ndryshimeve të këtij projektligji?

Jolanda Hyska – Së pari, qëllimi kryesor ka qenë të rritet forcimi i kontrollit dhe monitorimi i jodit në të gjitha nivelet.

Në vitin 1997 u bë VKM-ja e parë për përdorimin e kripës së jonizuar në nivel familjeje. Nga viti 1997, deri në vitin 2006, një periudhë gati 10-vjeçare, ne kemi pasur vetëm kripën e gjellës. Siç ju thashë, studimi i parë ka qenë në një situatë shumë të rëndë. Në vitin 2006 ne kemi bërë studimin e dytë të deficiencës jodike dhe nga 97% arritëm në 63%. Do të thotë se u pa shumë mirë që kripa e jodizuar ishte një metodë shumë e mirë e përzgjedhur për të ulur deficiencën jodike.

Niko Peleshi – Dakord.

Si e parashikon projektligji?

Sa është sot?

Jolanda Hyska – Nga viti 2006 në vitin 2008 ka një përmirësim. Nuk ngelëm me një VKM, por kaluam në një ligj për jodizimin universal të kripës, sepse, për sa kohë që ne, nga 97% shkuam në 63%, nuk mjafton vetëm kripa e tavolinës. Duke iu referuar Organizatës Botërore të

Shëndetësisë dhe Komitetit Ndërkombëtar të Deficencës Jodike, nëpërmjet Komitetit Kombëtar që funksionon pranë Ministrisë së Shëndetësisë u pa e arsyeshme të kalohej në një ligj, i cili u bë në vitin 2008. Nga viti 2008 deri në vitin 2013 ne pamë si funksionoi ligji në dy aspekte: në aspektin e kontrollit dhe në aspektin e monitorimit. Siç e diskutuam edhe pak më parë bashkë, monitorimi bëhet nga niveli i doganës deri në nivel familjeje. Ne, përveç kësaj, bëjmë edhe studimet në popullatë, studime tranzosale, për të kuptuar sa është jodi në urinë, për të kuptuar sa është deficienca. Për fat të keq, në vitin 2013, kur kishim jodizim universal të të gjithë kripës dhe të produkteve ushqimore që trajtoheshin me kripë, nga 63%, që ishim në vitin 2006, ishim në 49,6%, gati 50%, pra, 13% diferencë, kur prisnim që 95% e popullatës të ishte me marrje të mjaftueshme të jodit. Është jashtë objektivit tonë për t'u përmbushur.

Përveç gjendjes në popullatë, ne kemi ndjekur monitorimin dhe kemi kuptuar se, nëse më lejon me detaje, do të jap dy shifra: ADHS-i është studimi më i madh kombëtar demografik dhe shëndetësor në Shqipëri. Është bërë në vitet 2008-2009 dhe do të përsëritet në vitet 2017-2018, pra, një periudhë kohore 10-vjeçare. Kripa e jodizuar në nivel familjeje ka qenë 70% në vitet 2007-2008 dhe sot është 65%, që do të thotë se jemi mbrapsht, edhe pse normalisht e kemi pasur më të konsoliduar bazën ligjore. I kemi parë edhe nivelet e monitorimit dhe të kontrollit në nivele të ndryshme.

Unë do të doja të bëja edhe një saktësim për komentet, me të drejtë, e profesor Bares për çështjen e doganës. Në kontrollet periodike të subjekteve që kemi bërë ne, në nivel importi, kemi shpesh kamionë kripe pa jod ose me nivel jodi nën përcaktimin e ligjit. Ne nuk duam ta bëjmë këtë në kuadrin e sigurisë ushqimore, sepse në kuadrin e sigurisë ushqimore dhe të të gjitha ushqimeve që vijnë ...

Niko Peleshi – Ju lutem, mos i ezauroni të gjitha.

Na lejo t'i zbardhim pyetje pas pyetje.

Jolnada Hyska – Dakord.

Niko Peleshi – Kam një pyetje para se të marrë fjalën zoti Bare.

Ligji i vitit 2008 parashikon në mënyrë universale jodizimin e kripës, apo jo? Pra, nuk është ky ndryshimi që po bëjmë. Ishte universal dhe është universal detyrimi për fortifikimin e kripës. Cili është qëllimi i ndryshimeve të këtij projektligji? Ku ndryshon nga ai i vitit 2008. Çfarë përmirësimi po i bëjmë?

Jolanda Hyska – Së pari, e thashë që nuk ka funksionuar kontrolli, sepse edhe në rastin kur Inspektorati Sanitar Shtetëror konstatonte dhe jepte masat administrative, qoftë edhe gjoba, asnjëherë nuk u arrit të mblidheshin këto gjoba.

Niko Peleshi - Si e zgjidh ligji këtë gjë?

Jolanda Hyska – Në momentin që nuk mblidheshin, u pa se kjo ishte një pikë e dobët e saj.

E dyta, pati, gjithashtu, edhe një riorganizim të institucioneve. U krijuan institucione ...

Niko Peleshi - Ju lutem, çfarë përmirëson ky ligj? Çfarë bën ky ligj?

Jolanda Hyska – Ky ligj, më saktë, përcakton kompetencat, pra çfarë duhet të bëjë gjithsecili, dhe, veç këtyre, shtohet edhe gjurmueshmëria, e cila është shumë e rëndësishme për çështjen e kripës së jonizuar. Kripa hynte shpesh në doganë për përdorim joushqimor dhe përfundonte në tregun ushqimore.

Niko Peleshi - Kujt ia jepni si detyrim në këtë ligj gjurmueshmërinë?

Jolanda Hyska – AKU-së dhe Inspektoratit të Shëndetësisë.

Niko Peleshi –AKU-ja e ka, nuk ka nevojë për ndryshim në ligj, por gjithsesi do ta diskutojmë nen për nen.

AKU-ja ka për detyrë të garantojë ...

Jolanda Hyska – AKU-së dhe Inspektoratit të Shëndetësisë.

Niko Peleshi - E ka një institucion, por po ta kenë dy institucione, nuk do ta bëjë askush.

AKU-ja ka detyrimin të gjurmojë të gjitha ushqimet, në bazë të ligjit të ushqimit, ku çdo subjekt është i detyruar ...

Jolanda Hyska – Kjo është për pjesën e sigurisë, ndërsa për pjesën e jodit e ka detyrim Inspektorati i Shëndetësisë.

Niko Peleshi – Kam përshtypjen se jeni konfuze edhe në mendjen tuaj. Nuk e di si do të dalë në ligj, por do ta shikojmë.

Zoti Bare, urdhëroni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk mund të thuash dy institucione: edhe kjo me gjurmim, edhe ajo tjetra me gjurmim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për Gjurmueshmërinë e kam fjalën.

A bëhet fjalë për një ushqim? Kush ia heq të drejtën të kontrollojë kripën për ushqim.

(Diskutime pa mikrofon)

AKU-ja ka kompetencë të garantojë gjurmueshmërinë, të garantojë të gjithë procesin ...

(Diskutime pa mikrofon)

Areti Baruka – Vlerësimet e etiketës i rishikon AKU-ja.

Niko Peleshi – Faleminderit, për përgjigjet!

Me sa duket, nuk e keni as vetë të qartë.

Urdhëroni, zoti Baraj!

Besnik Baraj – Absolutisht, edhe ajri duhet të monitorohet dhe ka institucione që e monitorojnë. Ajri nuk është ushqim, s'ka kalori, meqenëse burimet e jodit tek organizmi janë ushqimi dhe kripa e jodizuar. Sasia e kripës që marrim ne është jashtëzakonisht e vogël. Ka njerëz të cilët nuk marrin kripë, sepse kanë probleme hipertensioni etj.

A ekziston mundësia që të jodi në ushqimet, të cilat i kemi domosdoshmërisht pjesë të ditës, bie fjala te buka e të tjera, aq më tepër që problematika e qëndrimit të kripës nëpër magazina mund të jetë e madhe dhe ulet, sikurse e thatë edhe ju, përmbajtja e jodi? Ka disa produkte ushqimore, të cilat nuk qëndrojnë nëpër magazina. A e keni parë ju si ministri mundësinë që të zëvendësoni, krahas kësaj, meqenëse është shumë problem që në Shqipëri, të fusim edhe produkte të tjera ushqimore, të cilat janë të jodizuara? A ekziston kjo përvojë në vendet e tjera?

Niko Peleshi – Urdhëroni!

Areti Baruka – Në fakt, ligji e përfshin edhe bukën dhe sot furrat e bukës duhet të përdorin kripë të jodizuar, sepse ligji është universal.

Niko Peleshi – Nuk e ka fjalën për ushqimet që kanë kripë, se u kuptua, nëse kripa është e gjitha e jodizuar, atëherë edhe ushqimet që përdorin kripë, të përdorin kripë të jodizuar, por po flasim për ushqimet që nuk kanë kripë.

Areti Baruka – Po pra, buka është një produkt që prodhohet dhe gjithë popullata ka akses. Kur u pa që jo vetëm kripa është e mjaftueshme, atëherë edhe për bukën duhet të përdoret kripë e jodizuar, përveç kripës së tavolinës.

Ndërsa për ushqime të tjera që të fortifikohen me jod dhe t'i ofrohet jod popullatës nga një ushqim tjetër ka mënyra të tjera, është mielli, është vaji, por kostoja e tyre është shumë e lartë, prandaj në Shqipëri është marrë në konsideratë kripa për t'u fortifikuar, sepse ka akses nga

të gjithë. Prej shtresave më të varfra konsumohet çdo ditë kripë dhe mund të themi se 5 gramë është e mjaftueshme.

Me të drejtë ju thoni se ka njerëz që nuk e konsumojnë kripën, por ne theksojmë se të gjitha ushqimet e tjera si buka, djathi e të tjera të bëhen me kripë të jodizuar, që në një mënyrë ose në një tjetër ata të arrijnë ta sigurojnë këtë sasi të nevojshme jodi.

Niko Peleshi – Dakord, por në këtë ligj, me sa kuptohet, vetëm sa përcaktohen më mirë, sipas jush, institucionet e monitorimit, inspektimit dhe kontrollit. Kaq.

Arete Baruka – Po, shtohet gjurmueshmëria, që nuk është, se për jodin në kripë në këtë rast, nuk bëhet fjalë për siguri ushqimore, por bëhet fjalë për të zgjidhur një çështje të shëndetit publik, që kërkon politika të veçanta.

Niko Peleshi – Ka edhe raste përjashtimore. Pra, përjashtohen produktet e eksportit dhe kripa ushqimore që importohet e pajodizuar me qëllim fortifikimi në vend. Këto të dyja?

Arete Baruka – Po.

Niko Peleshi – A ka pyetje të tjera? Diskutime?

Besnik Baraj – Zëvendësministri dje ishte i pranishëm këtu dhe bëri disa ndërhyrje dhe Komisioni i Shëndetësisë i mori parasysh, pra nuk i konsideroi problematike. Do të ishte mirë që ne të kemi draftin final të tyre...

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Urdhëroni, Roland!

Roland Kristo – Kujt i takon kompetenca? Po marr vetëm një shembull. Ju keni qenë ministër i Bujqësisë dhe e dini se në Tiranë, Durrës apo këto rrethet e mëdha nuk dallohet, por të marrim qarqet e vogla, për shembull, Kukësin, ku kemi një strukturë të AKU-së dhe një strukturë të shëndetësisë. Numri, operatori i bizneseve është i vogël. Inspektoratet përkatëse kanë një plan mujor për të bërë kontrolle dhe i bie që ato pak biznese që janë në Kukës, dy herë në javë inspektohen nga AKU-ja dhe dy herë të tjera nga shëndetësia. Pra, katër herë në javë u trokasin te dera inspektorët e shtetit, prandaj është çështja që po diskutohet dhe unë e di që është marrë vendim politik, që ato kontrolle të cilat kanë të bëjnë me të njëjtën tematikë, të jenë vetëm në një dorë. Nga ana e qeverisë është menduar që këto të kalojnë tek AKU-ja, e cila do të fuqizohet, dhe ky është një vendim politik i marrë nga qeveria.

Unë do të sugjeroja që në këtë projektligj të mos shkohet me emërtim të përveçëm ose në përcaktim të institucionit, se kush është përgjegjës. Të lihet në mënyrë gjenerike, pra të vendoset autoriteti kompetent për këtë kontroll.

Niko Peleshi – Dakord, dakord, se kjo është pjesë e diskutimeve nen për nen, kur të shkojmë te neni përkatës.

Roland Kristo – E thashë dje...

Niko Peleshi – Edhe këtë përsëritje e kishe.

Roland Kristo – Sot bëra shpjegimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në lidhje me diskutimin që bëra dje, unë i kam këtu gjërat për të cilat ramë dakord, që i mori parasysh edhe Komisioni i Shëndetësisë: e para, produktet ku mund të përdoret kripa e pajodizuar, janë produktet e destinuara për eksport, dhe e dyta kripa që bën pjesë në procesin teknologjik, me qëllim konservimin e ndërmjetëm. Pra, është pjesë e ndërmjetme e procesit.

Niko Peleshi – Sipas kartës teknologjike.

Roland Kristo – Sipas kartës teknologjike të miratuar nga AKU-ja.

Në këtë moment, domethënë kur kripa është në procesin e ndërmjetëm, që shërben si konservat ose për regjije, shpëlahet dhe pastaj futet në procesin tjetër, normalisht.

Këto ishin dy propozimet. Unë i kam edhe të shkruara fjalë për fjalë, dhe jua kam dërguar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

U kërkua ekzakt siç ka qenë.

Niko Peleshi – Zoti Beqaj. Pastaj zoti Pëllumbi.

Ilir Beqaj – Faleminderit!

Kam përshtypjen se me ato çfarë tha tash në fund zëvendësministri, e ngatërroi komplet situatën. Kjo për një arsye shumë të thjeshtë: zëvendësministri përfaqëson një ministri, e cila përcjell këtu mendimin e saj, sepse kur është votuar në qeveri, ministri përkatës ka qenë prezent. Kësisoj, ato që na thatë tashti keni pasur kohë t'i thoshit në qeveri. Jua kanë marrë apo s'ua kanë marrë për bazë, kjo punë ka mbaruar atje.

Unë kam përpara kërkesat për gjurmueshmërinë e ushqimeve, neni 25 i ligjit “Për ushqimin”. Kjo që lexojmë këtu, vetëm gjurmueshmëri nuk është. Po ju lexoj pikën 2. Kuptojeni

nëse është shqip, dhe kuptojeni nëse ka zot nënë që mund të shkojë e ta kontrollojë këtë lloj gjurmueshmërie:

“Operatorët e biznesit ushqimor krijojnë një sistem për mbajtjen e të dhënave, të quajtur bazë të dhënash, dhe garantojnë procedurat, të cilat mundësojnë dedikimin e tyre në çdo rast.”

Çfarë gjurmohet këtu? Më thoni se kush është inspektori që shkoi dhe cili është subjekti që mban një gjurmueshmëri, sipas kësaj gjëje? Pra, pse te ligj i ushqimit kemi gjurmueshmërinë, nuk e zgjidhim realisht gjurmueshmërinë te çdo komponent, që në këtë rast është kripa e jodizuar. Edhe nëse vijmë te propozimi, propozimi nuk është gjurmueshmëria, sepse keni thënë vetëm identitetin e subjektit dhe asgjë më shumë. Pra, operatori i biznesit ushqimor duhet të thotë vetëm se nga kush i erdhi furnizimi. Nga kush i erdhi, sa i erdhi, në ç’datë i erdhi, sa përqindje kishte përbërësi dhe çfarë skadence ka ai përbërës. Po ashtu: ku shkon? Nuk mjafton identiteti i çdo subjekti që operatori ka furnizuar me kripë. Kur e çoi, sa çoi, në ç’datë e çoi, në ç’datë skadon ajo që çoi dhe çfarë përbërësi ka? Kjo, nëse duam t’i gjurmojmë.

Ju vetë thoni diku: që bëjmë kontroll për importin. Po me prodhimin? Edhe prodhimi duhet kontrolluar. Edhe për analizat e prodhimit do të ketë tarifa. E keni në një nen, po kur vjen puna te kontrolli, flitet për tarifën në doganë. Në doganë nuk ka fabrikë prodhimi. Pastaj, nuk mund t’ia lëmë në dorë çdo lloj institucioni shëndetësor, që të shkojë e të kontrollojë: edhe drejtoria vendore, edhe rajonalja, edhe inspektoriat.

Ju si shëndetësi, gjeni të paktën një, që t’ia jepni këtë mandat. Sepse, me të drejtë e tha zëvendësministri: secili nga tre institucionet ka një plan pune, ka një metodikë të vetën. Jepjani vetëm njërit, që të merret me kripën e jodizuar, në funksion të shëndetit.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, kryetar!

Dua të specifikojë dhe një herë faktin se diskutimi që po bëjmë ne këtu, në këtë komision, ka të bëjë me thelbin e projektligjit, i cili në mënyrë specifike është i nevojshëm, i domosdoshëm, gjë që asnjëri prej nesh nuk e vë në diskutim. Por, ne si Komision i Veprimtarive Prodhuese, kemi edhe detyrimin për të parë nëse ky projektligj, në të mirën e tij të madhe, mund të sjellë dëmtime të vogla në aktivitetet tregtare dhe ekonomike. Kjo është arsyeja që ne kemi po diskutojmë dhe kemi bërë edhe disa ndryshime, disa amendamente të propozuara.

Ajo në lidhje me të cilën doja t'ju pjesa, meqenëse sot jeni këtu, është të dimë se cili është mendimi juaj: në rast se ne bëjmë këto përjashtime, ju e keni aftësinë të kontrolloni? E dëgjova pak më parë diskutimin tuaj, ku mes tjerash thatë se ligji ka qenë, por ne nuk kemi mundur ta ndjekim dot dhe s'kemi pasur rezultate., që s'kemi mbledhur gjoba, s'kemi mbledhur atë.

Tashti, në rast se në bëjmë këto përjashtime, dhe ne gjykojmë se disa aktivitete ekonomike kanë nevojë të mos përdorin kripë të jodizuar, a e keni ju aftësinë që këto përjashtime që do të bëjmë, të mos na dalin përsëri nesër në treg si konsum, a e kemi këtë organizim?

Antoneta Njehrrrena - Mund të bëj një sqarim për pjesën e parë, qëllimi kryesor i ligjit. Propozimi ynë fillestar si ministri e Shëndetësisë ka qenë ndarja e kompetencave, përcaktimi i institucioneve që do të bëjnë kontrollin dhe përcaktimi i institucioneve që do të bëjnë monitorimin.

Në ligj është përcaktuar se kontrolli do të përfshijë edhe pikat, edhe prodhimin, edhe kripën që importohet. Duke e ndarë në dy nene të posaçme nenin 12, që është kontrolli i kripës së jodizuar dhe kontrolli i kripës së jodizuar në pikat doganore. Në pikat doganore është përfshirja e doganës dhe përfshirja e institucioneve vendore të shëndetësisë, sepse rolin e inspektimit në kripën e jodizuar e ka vetëm inspektorati që mbulon fushën e shëndetit. Roli i strukturës shëndetësore është, sepse kjo e fundit ka laboratorin për të kryer marrjen e mostrës dhe për të bërë verifikimin që i shërben inspektoratit për të vlerësuar nëse kripa është në parametrat që e kërkon ligji.

Për sa i përket pyetjes tjetër do të flasë kolegja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Areti Baruka - Me ndryshimet e reja të ish -Drejtorisë së Shëndetit Publik, në emërtesën e gjatë, është në fakt i njëjti institucion. Elementet që solli Instituti për sa i përket...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Handikapi në këtë ligj, në argumentin që tha kolegja e Institutit për mosvjeljen e gjobave solli uljen e përqindjes në 49%. Ishte momenti i ndryshimit të inspektoratit nga vetëm sanitar që ishte, në inspektorat shëndetësor. Kjo është një periudhë kohore që zgjat. Prandaj në atë kohë ndodhi ky handikap jo vetëm për kripën e jodizuar, por dhe për shumë masa administrative edhe në fusha të tjera, gjë që nuk ekziston sot. Pikërisht prandaj erdhi ligji është

që të përcaktojë se cili do të bëjë ekzaminimin për sa u përket institucioneve shtetërore dhe cili ka të drejtën e inspektimit po nga institucionet shëndetësore. Ish- Drejtoria e Shëndetit Publik që e kishte tagër dhe e ka laboratorin shtetëror të përcaktuar për analizimin e kripës së jodizuar tashmë është nën emërtesën e re që quhet: strukturë vendore rajonale. Pra, është i njëjti laborator, e njëjta emërtesë, thjesht ka ndryshuar emri i gjatë. Ndërkohë që inspektorati nga “sanitar”, që ishte vetëm ligji sanitar nën juridiksion, tashmë quhet “shëndetësor” dhe njëri ka tagrin e analizimit ose të ekspertizës dhe tjetri ka tagrin e masës administrative, pasi monitorohet nga ky institucion dhe ia vë në dispozicion. Nuk e di nëse jam e qartë apo jo. Monitorimi është i vazhdueshëm, kurse inspektimi është në një moment x mujor ose plan vjetor të përcaktuar në objektet e veçanta.

Për të cituar atë që tha dhe zoti Baraj, statistikën nuk dalin dot pa monitorimin, do të bëhet monitorimi i vazhdueshëm që të shkohet te statistikat për të nxjerrë vlerën se sa e kemi hipotireozën sot. Pra, nga sëmundja vjen deri te monitorimi, mbrapsht.

Niko Peleshi - Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Propozimi i qeverisë thotë: “Kur kripa vjen nga importi edhe po të jetë e jodizuar do ta kontrollojmë patjetër”, tarifën do ta përcaktojë qeveria. Dakord. Po kur del nga fabrika vendase, a do ta kontrollojmë? Po, nuk ka nën tarife te kontrolli i brendshëm. Fjala “tarifë” është vetëm te neni i pikës doganore. Nesër do të nxjerrësh një tarifë për brenda, nuk e ke të bazuar dhe do të krijohen dy regjime johomogjene për të njëjtin shqetësim. Ju thoni: “E duam kripën me jod që të rrisim parametrat e jodit për shëndetin e shqiptarëve”. Shumë mirë. Ky në doganë do ta paguajë, ky i brendshmi pse nuk duhet që ta paguajë?

Niko Peleshi - Me këtë ligj vendosni një regjim më të fortë, nëse e vendosni, pasi unë nuk besoj se duke shtrënguar burokracinë vendoset kontrolli nën regjim më të fortë. Vetëm për 15 % të kripës, ndërsa për 85%, siç tha zoti Beqaj, ky ligj nuk sjell asnjë përmirësim.

Po, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Unë bëra një pyetje, ndoshta është pak e përgjithshme, por kërkova një opinion, të institucionit që nuk e kemi pasur këtu gjatë diskutimeve të tjera, që ka të bëjë me këtë gjë: a i kemi kapacitetet për të kontrolluar, në rast se ne bëjmë këto përjashtime që propozohen në amendamente? Po ose jo.

Areti Baruka - Absolutisht që po, pasi Inspektorati është tërësisht një institucion shtetëror: Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe ato që bëjnë laboratorin për matjen janë po të

njëjtat struktura publike shtetërore, ish-DSHP-të ose laboratorët pranë operatorit të ri. Ndërkohë që monitorimi që bën instituti ka tjetër tagër. Pra, në kuadrin e inspektimit...

Niko Peleshi – Më fal! Ju thatë “absolutisht”, por kjo është shumë e guximshme për ta thënë, sepse në qoftë se...

Jolanda Hyska – E bëjmë *gia*.

Niko Peleshi – ...institucionet bëjnë punën e tyre, atëherë nuk kanë pse të presin nga ne t’ua bëjmë me ligj detyrimin për të kontrolluar çdo ngarkesë, sepse e vlerësojnë vetë dhe thonë: “Ka risk, do të kontrolloj çdo ngarkesë”. Këtë të drejtë e kanë sot që flasim, nuk ka nevojë për ndryshim ligjor. Kjo ishte e para.

E dyta, në qoftë se ky ligj nuk përmirëson (kjo besoj se do të ishte përgjigjja më e ndershme) gjë në kërkesën e llogarisë së kontrollit në prodhim, atëherë përgjigjja për zotin Pëllumbi është negative. Kjo do të thotë se kripa që hyn e pajodizuar, që të jodizohet ose gjasme të jodizohet, mund të futet në kanalet e prodhimit ku regjimi i kontrollit është më modest se në doganë dhe nga prodhimi mund të shkojë përsëri e pajodizuar ose e keqjodizuar në treg, sepse ju vetë thatë se ky ligj përmirëson vetëm importin, hallkën e doganës dhe nuk përmirëson gjë në prodhim.

Ma thuaj nenin që përmirëson prodhimin!

Urdhëro!

Jolanda Hyska – Realisht, bëhet monitorimi në të gjitha pikat e prodhimit dhe fortifikimit të kripës në vend.

Niko Peleshi – Të lutem, se tani jemi pak...!

Jolanda Hyska – Janë 1800 e ca mostra që bëhen çdo vit.

Niko Peleshi – Për shkak të inteligjencës së gjithsecilit këtu, nuk meritojmë të fyhemi. Nuk po flasim për çfarë bëhet aktualisht, por po themi çfarë përmirëson ky ligj. Ne nuk e njohim situatën, ju e njihni. Ju thatë se kemi probleme e po shkojmë keq e më keq...

Tani, çfarë përmirëson ky ligj në proceset e prodhimit vendas? Këtë përgjigje na jepni!

Ma lexo nenin, ku ky ligj përmirëson duke forcuar kontrollin, duke e vendosur në një regjim më të saktë monitorimin e të tjera! Ku? Në cilin nen të këtij projektligji përmirësohen hallkat e tjera, përveç importit, nga prodhimi deri në shitje, për 85% të sasisë së kripës? A ka përmirësim?

Jolanda Hyska – A mund të shpjegoj diçka?

Niko Peleshi – Urdhëro!

Jolanda Hyska – Në të dyja nenet e kontrollit, edhe në pikat e prodhimit, edhe në import, është parashikuar kontrolli nëpërmjet marrjes së mostrës dhe kryerjes së analizave. E vetmja gjë, që mbase kërkon edhe një sqarim më tepër, është pjesa e tarifës, e cila vendos...

Niko Peleshi – Të lutem, nuk po flasim për tarifën! Të mos keqkuptohemi!

Jolanda Hyska – Marrja e mostrës dhe kontrolli nëpërmjet...

Niko Peleshi – Nuk jemi të shqetësuar për 350 lekë që do të paguajë subjekti. Le të paguajë edhe 3500! Nuk është çështja këtu.

Nëse këtu pati një lloj debati për kontrollin e çdo ngarkese në doganë, çështja ishte te vonesa dhe burokracia, jo te 350-lekëshi. Gjithsesi, nuk po ju pyesim për këtë, por për proceset e tjera në prodhim.

Çfarë përmirëson ky ligj? Se mbase ligji aktual është plotë dhe nuk ka nevojë të përmirësohet gjë. Po të ishte i plotë, atëherë ose çalon ligji, ose çalojnë institucionet. Në qoftë se çalojnë institucionet, ju lutem, mos kërkon ta zgjidhni me ne, se nuk kemi...! Nuk zgjidhet me deputetët çështja e institucioneve.

Pyetja është: Në proceset e tjera, përveç doganës, çfarë përmirëson ky ligj?

Jolanda Hyska – E njëjta metodologji kontrolli është si në prodhim, ashtu edhe në import, pra vlerësimi i jodit në kripë nëpërmjet marrjes së mostrës dhe kryerjes së analizave.

Niko Peleshi – Është e detyruar për çdo mostër, për çdo ngarkesë, për çdo lot, edhe në prodhim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jolanda Hyska - Për çdo parti malli konsiderohet. Pra, sot quhet lot, për çdo parti malli quhej në rregulloren e vjetshme. Kjo do të thotë se fabrika e prodhon, e magazinon. Ai ka grumbulluar të dy ditëve dhe thotë: “Prodhova 3 tonë apo 5 tonë” apo ku ta di unë se çfarë! Kjo konsiderohet parti malli, merret mostra...

Niko Peleshi – Të lutem, mos më shpjego procesin! Në qoftë se jeni të papërgatitur, e shtyjmë, nuk ka problem, se nuk kemi urgjencë. Në qoftë se jeni të përgatitur, na thoni numrin e nenit në këtë projektligj, që, krahasuar me vitin e kaluar, përmirëson kontrollin apo monitorimin në prodhim!

Jolanda Hyska – Neni aktual për ligjin ka qenë: “Kontrolli i kripës së jodizuar dhe monitorimi i kripës së jodizuar”.

Nisur nga shqetësimet që ka pasur edhe inspektorati gjatë veprimtarisë së tij dhe gjithë këto përplasje në mënyrën e ushtrimit të kontrollit, është vendosur që në propozimin e ri të ligjit të kemi dy nene të posaçme, që lidhen me kontrollin e kripës në përgjithësi, në të gjitha pikat, në prodhim, import, në kripën e jodizuar të prodhuar ose të importuar, duke përfshirë edhe pjesën e monitorimit, duke ndarë edhe institucionet që kryejnë monitorimin dhe kontrollin...

Niko Peleshi – Si ishte dhe si është? Kaq na thoni, se mbase është zgjidhur dhe po debatojmë kot!

Jolanda Hyska – Qëllimi ka qenë të bëhen saktësime dhe të përcaktohen më qartë përgjegjësitë, se kush do të bëjë...

Niko Peleshi – Si është në ligjin aktual dhe si propozohet në projektligj?

Jolanda Hyska - Janë dy nene të gjata. Në qoftë se mund t'i lexoj...

Niko Peleshi – Më thuaj numrin e neneve.

Jolanda Hyska – Neni 12 dhe neni 13 në ligjin ekzistues. Është riformuluar neni 12 dhe është shtuar neni 12/1, për kontrollin në pikat doganore.

Niko Peleshi – Zonjë, të lutem! Nuk po të pyes për pikat doganore, por për prodhimin. Në prodhim, a ndryshon gjë ky ligj apo e lë siç ka qenë? Nëse po, më thuaj si ka qenë dhe si është!

Jolanda Hyska – Në lidhje me kontrollin në prodhim nuk ka ndonjë ndryshim...

Niko Peleshi – Po këtë na thuaj! Në rregull.

Duke e përmbledhur, edhe në përgjigje të...

Jolanda Hyska – Është saktësuar...

Niko Peleshi – Të lutem! Kur të ta jap fjalën...

Për ta përmbledhur, ky projektligj ka për qëllim të përmirësojë apo të forcojë kontrollin, monitorimin, gjurmueshmërinë (të gjitha proceset e kontrollit) për kripën e importuar, që përbën 15% të kripës që konsumohet në vend. Për 85% të kripës që konsumohet në vend, e cila prodhohet në vend, ky ligj nuk sjell nuk asnjë përmirësim. A mund ta themi këtë?

Sapo e thatë tani.

Jolanda Hyska - Jo, për arsye se e thamë që ky ligj do të përcaktojë kompetencat e tri institucioneve që, deri dje, ishin një, pra Inspektorati Sanitar me laboratorin ku bëhej ekzaminimi, quhej ish-Drejtoria e Shëndetit Publik. Me ristrukturimin, ku inspektorati është një institucion dhe operatori DSHP-ja është një institucion tjetër, përcaktohet që ky ka të drejtën e

marrjes së mostrës, por edhe të masave administrative, ndërsa ky institucioni tjetër ka të drejtën e ekzaminimit laboratorik. Ndërkohë Instituti i Shëndetit Publik në institucionet shëndetësore është për monitorim të vazhdueshëm, për studime, për politika shëndetësore, pra përcakton dhe kompetencat.

Niko Peleshi – Zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Po del e qartë se çfarë doni të përmirësoni me këtë projektligj, por nuk e keni të shkruar kështu. Pse? Sapo cituat një rregullore dhe thatë që atëherë e quajë parti, sot e quan lot. Te neni 12, ku ti përpiqesh të saktësosh më shumë kompetencat e hallkave të shëndetësisë për prodhimin ose importin, do të duhet të shtojmë nen për nen që ministri jo vetëm përcakton institucionet ku kryhen analizat, por edhe çfarë do të thotë monitorim dhe si bëhet, sepse fakti që ti do të shkosh nesër lot për lot apo jo nuk e vendos një rregullore, siç e ke thënë këtu që në doganë do ta bëj një për një. Të paktën të themi këtu nen për nen që ministri jo vetëm do të përcaktojë laboratorët e institucionit, por edhe se cila do të jetë korniza, se po të jetë kështu mund të të teket ty, ose mund të të lindë dëshira të bësh një rregullore që mund t’ua nxish jetën të gjithëve, sepse i vë vetes target, duke thënë se unë jam institucion dhe për 4 vjet do të arrij që atë 49-ën ta bëj 62 dhe për ta bërë këtë në 4 vjet mund t’i duhet të kapërcejë ylberin, sepse atë objektiv i vë vetes ministria, pra nga 49 në 62 do t’i shkurtojë në 4 vjet shpenzimet për sëmundjet me kaq lekë. Është objektiv legjitim, por nuk mund ta lëmë kaq të hapur nëse këtu nuk do të ankorojmë, sepse ke hyrë vetë në detaje tek importi, ndërsa pjesën e përgjithshme të prodhimit e ke lënë në mënyrë shumë më gjenerike.

Niko Peleshi – Fjalën e ka zoti Bici, më pas zoti Pendavinji.

Dritan Bici – Nuk e kemi ditur që në fillim që bëhej fjalë për 15%-shin, i tërheq ato fjalë që thashë dhe nuk i hyj fare kësaj pune. Megjithatë serioziteti me të cilën e kemi marrë këtë punë e justifikon qëllimin që ka ky ligj, edhe debati, por unë do të thosha që kjo punë është e pastudiuar mirë. Eksperienca si e zëvendësministrit, si e Beqaj si ish-ministër i Shëndetësisë, apo e profesor Baraj nuk mungon, prandaj dëshira ime është që të ishte më nën kontroll. Po ta dija që po luftojmë për të rregulluar 15 përqindëshin nuk do ta thosha. Mendimi im është se duhet saktësuar mirë sasia e kripës që importohet dhe sasia që prodhohet, si dhe të saktësohen ato që tha zoti Beqaj, pra çfarë do të bëhet dhe si do të jetë kontrolli i kësaj. Deri tani ligji thotë çfarë bëhet me kripën e importit dhe jo që ka shtrëngesë për 85 përqindëshin, kështu që ju jeni kryetar

i komisionit dhe e dini se çfarë duhet bërë. Ndoshta nuk e kemi me nxitim këtë punë, por që ta saktësojmë tamam mbase duhet të marrim informacion.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Pendavinji keni fjalën.

Më pas zoti Pëllumbi.

Ilirjan Pendavinji – Unë dua ta them shkurt, sepse nga diskutimet e kolegëve doli qartë që pjesa më shqetësuese, pra 85%, është lënë më pak e kontrolluar se pjesa tjetër që përbën 15 përqindëshin. Çfarë do të thotë kjo? Nëse në nenin 5, që është korrigjimi i nenit 12/1, ne përcaktojmë kontrollin e kripës së jodizuar ne pikat doganore, atëherë duhet të ketë një nen tjetër për kontrollin e kripës së jodizuar në vendet e prodhimit vendas dhe mbase, me të njëjtin përcaktim që është thënë këtu, pra që do të kontrollohet çdo lot, të bëhet edhe për pjesën e pagesave. Pra, të formulohet një nen 12/2 me të njëjtat përcaktime, që të kontrollohet më mirë pjesa e prodhimit.

Niko Peleshi - Megjithëse fjalën e ka zoti Pëllumbi, po ia kaloj zotit Baraj për një fjalë.

Besnik Baraj – Në fakt, gjithë ajo problematikë aq e madhe që ka sjellë në shëndet jodi duket që qëndron te kripa, e cila përgatitet në vend dhe mendoj se, nëse duam që atë 49,6%-in ta ulim dhe ta çojmë 30% apo 20%, duhet të bëhet patjetër një kontroll shumë më rigoroz për kripën që prodhohet në vend. A përdorin njerëzit 85% të tij apo jo, nuk është ky problemi edhe sikur ta shtrëngojnë më shumë, apo ta ndalojnë fare kripën e importit, sepse ne e kemi problemin te kripa e vendit.

Niko Peleshi – Po zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti kryetar!

Duke dëgjuar të gjitha diskutimet që bëmë këto ditë më lindi një pyetje. Doja të dija çfarë ndodh me kripën kur çjodizohet? Ku shkon?

Niko Peleshi – Për ta plotësuar. Po produktet që mund të kenë një datë skandence 1 vit, ndërkohë që thamë se pas 6 muajsh kripa e humbet jodin, konsiderohen të skaduara?

Fjala për ju.

Jolanda Hyska – Faleminderit!

Së pari, ju kërkoj ndjesë, se ndoshta nuk u shpreha qartë dhe e dhashë shkurt përgjigjen në lidhje me importin dhe prodhimin e kripës së jodizuar!

Ka ndryshuar përqinja e kripës së jodizuar të importuar në raport me kripën që fortifikohet në vend, por sasia, në fakt, e kripës së prodhuar në vend dhe që jodizohet nuk shkon më shumë se 60 %-70 %. I vetmi burim i prodhimit të kripës së jodizuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Sa është kripa e vendit?

Areti Baruka – Kripë që prodhohet në vend?

Niko Peleshi – Po.

Areti Baruka – Ne kemi vetëm një fabrikë që prodhon kripë në vend, fabrikën e Vlorës, e cila pjesën më të madhe të prodhimit të saj e ka për eksport të pajodizuar, ndërsa një sasi shumë të vogël e jodizon për në vend. Pjesa që fortifikohet në vend dhe që sot është, unë jua thashë, rreth 85%, importohet e pajodizuar. Prandaj ka kaq rëndësi importi për ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, pra, ajo ka ardhur dhe ka vazhduar kështu. Vinte e pajodizuar për destinacion joushqimor, pastaj merrej dhe dalëngadalë filloi të jodizohej. Duke u parë kjo tendencë sot, u lejua importi i kripës së pajodizuar, por me kushtin që ajo të jodizohet. Kjo do të thotë...

Niko Peleshi – Edhe një herë, sa për qind të tregut ka kripa e prodhuar në vend? Pra, sa për qind e kripës që konsumohet në vend prodhohet në vend?

Areti Baruka – Më lejoni... Termat “kripë e prodhuar në vend” me “kripë e jodizuar, e fortifikuar në vend” janë dy gjëra të ndryshme.

Niko Peleshi – Jo, nuk janë të ndryshme, sepse...

Areti Baruka – Atëherë, ne prodhojmë kripë. Fabrika e Vlorës...

Niko Peleshi – Ju lutem! Nuk janë të ndryshme në kuptimin e ligjit, ndërsa në kuptimin praktik nuk e di, ndoshta e gjithë kripa që përdoret është e pajodizuar. Por në kuptim të ligjit, 100% e kripës që përdoret për ushqim duhet të jetë e jodizuar, pra në kuptim të ligjit është e jodizuar. Atëherë, sa për qind e kripës që konsumohet në vend si ushqim, prodhohet në vend?

Areti Baruka – Sa për qind e kripës së jodizuar, doni të thoni?

Niko Peleshi – Sa për qind e kripës ushqimore, sepse kripa e jodizuar është 100% e jodizuar, në kuptimin e ligjit.

Areti Baruka – Për sa kohë ne themi se kemi 65% kripë të jodizuar në treg, dhe gjejmë 35%, do të thotë se ne kemi ende kripë të pajodizuar. Ndërsa, në qoftë se flasim për kripë të

jodizuar, nga monitorimi i kripës së jodizuar që ne gjejmë në treg sot, 15% vjen nga importi e jodizuar dhe 15% fortifikohet në vend, pra del nga prodhimi vendas.

Niko Peleshi – Kripa që përdoret në konsum ushqimor, është 100%. Nga ky 100%, sa për qind është kripë vendase?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Areti Baruka – Nga ky 100%, ne themi se 65% është e jodizuar dhe 35% e pajodizuar, këtë 65%-shin e jodizuar e ndajmë në 85% nga vendi dhe 15% nga jashtë. Kjo është e dhëna.

Niko Peleshi – Ekzakt! Pra, të gjitha diskutimet tona qëndrojnë.

Areti Baruka – Nuk qëndrojnë.

Diskutimi është ky: për sa kohë që në këtë 65%, kemi këtë 85-shin dhe nga ky i fundit, pjesa më e madhe e kripës vjen e pajodizuar, domethënë pika është dogana...

(Deputeti Beqaj ndërhyr pa mikrofon.)

Vetëm 15%.

Ilir Beqaj – ...75% e kripës ushqimore të Shqipërisë.

Niko Peleshi – Ekzakt. Është edhe më keq situata.

Areti Baruka – Po, por pjesa tjetër, domethënë ne kemi kripë të pajodizuar. Përveç të tjerave, nga ky 35%-shi i pajodizuar që gjendet në treg, një pjesa më e madhe vjen nga jashtë. E dimë sa e ka kapacitetin fabrika e Vlorës, nuk është burimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Ju lutem, mos e ngatërroni!

Neve na intereson...

Areti Baruka – Dua të them që sasia e kripës nuk është 15%-shi.

Niko Peleshi – Ne nuk “mbytemi” në shifra, zonjë! Ju lutem!

Areti Baruka – Sasia e kripës që hyn në import nuk është ajo.

Niko Peleshi – Ju lutem, mbylleni pak mikrofonin!

E para, mos merrni më guximin që të na ngatërroni me shifra! Nuk ngatërrohemi, të gjithë kemi bërë shkollë fillore, se këtu po bëhet fjalë për aritmetikë! Me shifra nuk na ngatërroni dot! Me shifra, me sa duket, jeni ose të ngatërruar, ose doni të ngatërroheni!

Llogaria, siç e tha zoti Beqaj, është edhe më keq. Pra, nuk është 15%, por është 9%, sepse është 15%-shi i 65%-shit, që është i jodizuar. Pjesa tjetër është dështim sistemi. 35%, që është

kripë e pajodizuar, është dështim institucionesh, jo dështim i ligjit, se ligji e ka 100% kripën e jodizuar!

Ajo punë mund të rregullohet edhe me ligj, në qoftë se vendosim disa pika mbi “i” ose masa më të forta të regjimit të kontrollit, gjurmueshmërisë dhe monitorimit, por, përgjithësisht, është punë e përgjegjshmërisë së institucioneve dhe e kontrollit institucional.

Me llogari, 9% ose 10%, po e rrumbullakosim, e kripës, që konsumojnë shqiptarët, vjen nga importi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni? Po, pra, ajo e jodizuar, nuk ka rëndësi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

9% e kripës që konsumohet është kripë importi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vetëm 9%.

Me këtë ligj ne po rregullojmë (në qoftë se po rregullojmë, se nuk duket sikur po rregullojmë, më shumë kemi konfuzion) këtë 10%-shin ose 9%-shin. Kaq, këtu nuk ka debat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, po e them siç kemi draftin!

Kështu që, ju lutem, për këtë draft (se nuk ka nevojë për debat, tani ky është shqetësim i përbashkët, pra edhe juaji dhe yni) ne kemi përgjegjësi derisa ta nxjerrim nga dora dhe pastaj jemi të shqetësuar si konsumatorë, ndërsa ju jeni të shqetësuar në vijimësi, pasi jeni institucionet përgjegjëse për monitorimin dhe zbatueshmërinë e këtij ligji në proces. Pra, nuk ka nevojë për debat. Situata është që me anë të këtij ligji (kur ta shohim nen për nen, do ta fiksojmë më mirë) ne synojmë që të vëmë pikat mbi “i” për institucionet e kontrollit, pra të forcojmë kontrollin për kripën e importit. Jemi dakord. Nuk ka asgjë të keqe, madje është shumë mirë.

Ju lutem, në qoftë se doni të kontribuoni në proces (ne nuk po e mbyllim sot, por po e votojmë vetëm në parim) në ditët në vazhdim (mbledhjen tjetër do ta lëmë në fillim të javës që vjen) mendojeni dhe na sillni ndonjë kontribut për të rregulluar nen për nen edhe pjesën e prodhimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, ç’ mund të shtojmë kërkesa, përgjegjësi ose kompetenca të institucioneve përkatëse për të forcuar kontrollin dhe për të përmirësuar kontrollin në hallkat e tjera: nga prodhimi,

tregtimi me shumicë, tregtimi me pakicë e të tjera, siç e keni zgjidhur, sipas jush, çështjen e importit duke vendosur kontrollin e detyrueshëm për çdo mostër, pra ndoshta keni ndonjë ide tjetër për hallkat e tjera. Ju lutem, mendohuni dhe na i sillni me shkrim, ose na i prezantoni në seancën tjetër që do të kemi diskutimin nen për nen.

Ka ndonjë diskutim tjetër? Nuk ka.

Atëherë, e hedhim në votim në parim. Kush është dakord në parim me projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9942, datë 26.06.2008 “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut”, i ndryshuar”, i ardhur nga Këshilli i Ministrave?

Kundër? Një votë kundër (zoti Shtjefni). Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.

Në mbledhjen tjetër do të kemi diskutimin nen për nen. Ju lutem, sillni propozimet tuaja; e kam fjalën edhe për institucionet, edhe për deputetët. Do të diskutojmë për variantin e qeverisë dhe do të konsultojmë amendamentet, pra variantin e qeverisë dhe propozimet e institucioneve që do të vijnë deri javës tjetër.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA